



## UNE MESOJ GJERMANISHT, FEMIJA IM GJITHASHTU

**Të dashura nëna, nëse ende e flisni shumë pak gjermanishten apo nuk e dini fare dhe nëse keni fëmijë të moshës që ende nuk e kanë vizituar kopshtin, atëherë një MuKi-kurs është i mirë për ju. A keni pyetje? Për shembull:**

### **Pse duhet të mësoj gjermanisht?**

Sepse duke mësuar gjermanisht mësoni shumë për jetën në Zvicër.  
 Sepse ju në një grup me nënat e tjera dhe me mësuesen mund të shkëmbeni mendime për edukimin dhe çështjet e tjera të përditshme.  
 Sepse ju mund ta përkrahni më mire fëmijën tuaj kur të shkojë në kopsht apo në shkollë.  
 Që të njiheni sistemin tonë shkollor dhe më vonë të mund të bisedoni me mësuesen apo mësuesin e fëmijës suaj.  
 Sepse ju jeni shembulli për fëmijën tuaj sa i përket të mësuarit gjermanisht.

### **A mund ta vizitoj MuKi - kursin e gjermanishtes nëse nuk di të shkruaj dhe të lexoj?**

Jo. Ju duhet të dini të shkruani dhe të lexoni alfabetin latin.

### **A mund ta vizitoj MuKi- kursin e gjermanishtes nëse nuk banoj në Bernë?**

Kurset parimisht janë menduar për gratë që jetojnë në Bernë. Por në rast se në ndonjë kurs ka ende vende të lira mund të bëhen përjashtime.

### **Në cilën moshë duhet të jenë fëmijët për të vizituar një MuKi – kurs të gjermanishtes?**

Normalisht rreth moshës 3-5 vjeç. Fëmijët më të vegjël mund të merren në përkujdesje sipas marrëveshjes me udhëheqjen e projektit apo mësuesen e kursit.

### **Pse janë të mira MuKi - kurset e gjermanishtes për fëmijët?**

Sepse fëmijët kanë qejf të luajnë dhe sajojnë bashkë me fëmijët e tjerë.  
 Sepse fëmijët kanë qejf të dëgjojnë tregime, të këndojnë këngë dhe të mësojnë vjersha.  
 Sepse fëmijët mësojnë se si të orientohen në një grup.  
 Sepse fëmijët mësojnë gjermanisht. Ata mësohen ta kuptojnë gjermanishten dhe varësisht nga moshën mësojnë shumë fjalë. Kur ta vizitoni kopshtin kjo ju ndihmon atyre shumë.

### **Kush i mban kurset?**

Udhëheqëse të kursit janë mësueset dhe udhëheqëset e lojës grupore (Spielgruppe), që kanë përvojë në dhënien e mësimi të gjuhës gjermane si gjuhë e dytë.

### **Si është i organizuar një MuKi- kurs i gjermanishtes?**

Kursi fillon pas pushimeve të verës dhe zgjasë një vit. pra afërsisht 12 muaj. Ju do të mësoni gjermanisht dy orë gjatë javës. Materialin mësimor do ta merrni në kurs. Paralelisht me këtë fëmijët do të mbikëqyren nga dy persona të specializuar dhe 2 orë rresht do të mësojnë gjermanisht në lojën grupore (Spielgruppe). MuKi- kurset e gjermanishtes do të mbahen në vende të ndryshme të qytetit.

### **Sa është kapaciteti i kurseve?**

6-12 gra për kursin e nënave, 6-12 fëmijë për kursin e fëmijëve.

### **Si dhe deri kur mund të regjistrohem në një kurs?**

Plotësojeni formularin e paraqitjes dhe dërgojeni deri me **5 korrik** në adresën e shënuar në pjesën e prapme të talonit për paraqitje. Nëse ka ende vende të lira është e mundur pjesëmarrja në një kurs aktual.

### **Sa kushton një MuKi- kurs i gjermanishtes?**

Shpenzimet e kursit janë për ju dhe për fëmijët gjithsej 300 franga. Ju e paguani kursin në fillim të kursit. Me kërkesë është e mundur që ta paguani shumën me këste. Nënat të cilat sjellin me vete një pjesëmarrëse të re marrin 30,- franga rabat.

### **A jam unë apo fëmija im gjatë kursit të siguruar?**

Jo. Ju duhet ta keni një sigurim privat ndaj aksidentit dhe sigurimin për dëmshpërblim /zhdëmtim (Haftpflicht).

### **Ku mund të marr edhe më shumë informacione?**

Te Schulamt të qytetit të Bern -it, Schulamt der Stadt Bern, Effingerstrasse 21, 3008 Bern, tel. 031 321 64 43. E-Mail: schulamt@bern.ch.  
 Kjo broshurë mund të shkarkohet në 11 gjuhë të ndryshme nga faqja e internetit : <http://www.bern.ch/stadtverwaltung/bss/schule>